

Më
Dana

22.08.2017

PKR.nr.75/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE

RENDA, kryetari i trupit gjykues Sahit Krasniqi me sekretaren juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.84/17, të dt. 30.05.2017, për veprën penale " dhënia e ryshfetit " nga neni 429 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, në bazë të nenit 495 të KPP-së, me dt. 30.06.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.84/17, të dt. 30.05.2017, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurit [REDAKTUAR], i lindur me datën [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR], me vendbanim në rr. "[REDAKTUAR]" nr. [REDAKTUAR], R. [REDAKTUAR], me numër personal [REDAKTUAR], me numër te letërnjoftimit, [REDAKTUAR], mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: me datën 19 Maj 2017, rreth orës 10:00, ne terminal doganor ne Han te Elzeit, iu ka ofruar dhuratë personave zyrtar në mënyrë që të mos veprojnë në pajtim me detyrat e tyre zyrtare, në atë mënyrë që me rastin e kontrollimit nga ana e policisë në hyrje të terminalit është ndaluar kamioni Mercedes me targa [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], të cilin e drejtonte i pandehuri, i cili së bashku me dokumentacionin e kamionit dhe pasaportës, iu ka ofruar dhuratë në shumë prej 10 euro personit zyrtarë-policit [REDAKTUAR] me qëllim që i njëjti të mos veprojë në pajtim me detyrat zyrtare, të lëshoj të pandehurin pa i kryer kontrollat e zakonshme të dokumentacionit.

-me këtë ka kryer veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.1 të KPRK-së.

Andaj konform nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 21, 41, 42, 43, 46, 73 të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së,

G J Y K O N

Me DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300 (TREQIND) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.

Konform nenit 62 par.2 nënpar 2.6 dhe nenit 69 par.1 të KPPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i sendit – kartëmonedhës prej 10 euro me numër serik NA5635190818, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale të dhënies së ryshfetit.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.84/17, të dt. 30.05.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] për veprë penale “dhënia e ryshfetit” nga neni 429 par.1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 të KPP-së.

Gjykata me rastin e vlerësimit të provave materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i dt. 19.05.2017 kartëmonedha me numër serik NA5635190818 si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës, vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 62 par.2 nënpar 2.6 dhe nenit 69 par.1 të KPPRK-së, të pandehurit iu shqiptua dënimi plotësues konfiskimi i sendit – kartëmonedhës prej 10 euro me numër serik NA5635190818, e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale të dhënies së ryshfetit.

Konform nenit 450 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 euro, në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME
TE RENDA, PKR. nr. 75/17 të dt. 30.06.2017.**

Sekretare Juridike

Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues

Sahit Krasniqi



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.